



RAPORTI VETËVLERËSIMIT

UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS

2021-2022

VETËVLERËSIMI PËRGJAT VITIT AKADEMIK 2021-2022

Realizimi

Raporti i Vetëvlerësimit paraqet një studim të funksionimit institucional të UAMD-së dhe përmbushjen e standardeve të cilësisë për vitin akademik 2021-2022. Raporti është hartuar duke u bazuar në 5 fushat e vlerësimit:

- 1. Organizimi dhe Menaxhimi**
- 2. Burimet**
- 3. Kurrikula**
- 4. Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi**
- 5. Studentët dhe Mbështetja e tyre**

Ky raport përmbledh evidencat me anë të së cilave vlerësohet përmbushja e standardeve të cilësisë të veprimtarive akademike dhe mësimore dhe mundëson analizimin e nevojave dhe vendosjen e objektivave për zhvillimin e cilësisë.¹

Qëllimi

Vetëvlerësimi ka si qëllim prezantimin e punës të organizuar brenda një viti akademik në Universitetin ‘Aleksandër Moisiu’ Durrës , prezantim ky që hartohet në kuadër të procesit të Akreditimit Institucional dhe akreditimit të programeve të studimit që ofrohen pranë IAL-së.

Qëllimi i këtij vlerësimi është inkurajimi i IAL-së që të punojnë për rritjen e vazhdueshme dhe sistematike të cilësisë së ofertës akademike dhe përmirësimin e kushteve të mësimdhënies dhe mësimnxënies të studentët. Në kuadër të këtij misioni, ky raport synon të japë informacion mbi objektivat, procedurat dhe pritshmëritë e këtij procesi vlerësimi, përfshirë ato që lidhen me pikat e referencës së gjykimit, mbledhjen e të dhënave, grupet e vlerësimit të jashtëm dhe vetë procesin e vlerësimit.

RVB shërben njëkohësisht edhe për të rikonceptuar strategjinë, objektivat, vizionin dhe misionin e universitetit me synimin për të ngritur në një nivel gjithnjë e më të lartë shkallën e performancës dhe efektivitetin e punës për të garantuar vazhdimësinë e sigurimit të cilësisë.

¹Rregullorja e Sistemit të Brëndshëm të Sigurimit të Cilësisë (Dokumenti I)

“

“QUALITY... is everyone's
responsibility”

-W. Edwards Deming

”

Vetëvlerësimi në UAMD

Në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës sigurimi i cilësisë është një prioritet.

Gjatë vitit akademik 2021-2022 aplikua për akreditimin insitucional i cili mori vlerësim POZITIV duke u akredituar me vlerësim të lartë me kohëzgjatje 4 (vite) akademike. Zgjerimi me programe të reja pasqyron më së miri azhornimin e vazhdueshëm me kërkesat e tregut të punës kombëtare dhe ndërkombëtare.

Gjatë vitit akademik 2021-2022 aplikua gjithashtu për akreditimin e disa programeve studimi.

Në Fakultetin e Studimeve Profesionale aplikua për :

- ✓ 4 (katër) programe studimi Bachelor
- ✓ 1 (një) program studimi Master Profesional
- ✓ 8 (tetë) programe studimi me Karakter Profesional

Ne Fakultetin e Biznesit aplikua për :

- ✓ 6 (gjashtë) programe studimi Bachelor
- ✓ 5 (pesë) programe studimi Master Shkencor
- ✓ 1 (një) program studimi Master Profesional

Ne Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit aplikua për :



- ✓ 5 (pesë) programe studimi Bachelor
- ✓ 2 (dy) programe studimi Master Shkencor
- ✓ 1 (një) program studimi me Karakter Profesional

Ne Fakultetin e Shkencave Politike Juridike aplikua për :

- ✓ 3 (tre) programe studimi Bachelor
- ✓ 4 (katër) programe studimi Master Shkencor

✓ Ne Fakultetin e Shkencave Politike Juridike aplikua për :

- ✓ 6 (gjashtë) programe studimi Bachelor
- ✓ 6 (gjashtë) programe Master Profesional
- ✓ 3 (tre) programe studimi Master Shkencor



(Në Figurat e mësipërme paraqiten, Çertifikata e Akreditimit Institucional, dhe çertifikatat e akreditimit të programeve të studimit)

HISTORIKU I UNIVERSITETIT “ALEKSANDËR MOISIU” Durrës

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës është një institucion publik i arsimit të lartë i krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Nr. 801, datë 20.12.2005 “Për hapjen e Universitetit “Aleksandër Moisiu” në Durrës.

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës (në vijim UAMD) i hapi dyert për herë të parë në vitin akademik 2006-2007, me rekrutimin e rreth një mijë studentë nga pothuajse të gjitha trevat e vendit. Fillimisht universiteti ishte i përbërë nga tri njësi kryesore, si më poshtë:

- 1- Fakulteti i Edukimit
- 2- Fakulteti i Ekonomisë dhe Administrimit
- 3- Shkolla e Lartë Profesionale.

Me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 685, datë 25.08.2010 “Për riorganizimin e Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, në fillim të vitit të ri akademik 2010-2011, universiteti u zgjerua dhe me dy fakultete të reja, Fakultetin e Shkencave Politike-Juridike dhe Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit. Gjithashtu, u riorganizuan njësitë kryesore të universitetit duke bërë të mundur që sot në përbërje të tij të jenë 5 fakultete si Fakulteti i Biznesit, Fakulteti i Edukimit, i Teknologjisë së Informacionit, Fakulteti i Shkencave Politike-Juridike, Fakulteti i Studimeve Profesionale, si dhe filiali në qytetin e Peshkopisë, të organizuar në pesë njësi kryesore, si më poshtë:

- 1- Fakulteti i Biznesit;
- 2- Fakulteti i Shkencave Politike Juridike;
- 3- Fakulteti i Edukimit;
- 4- Fakulteti i Studimeve Profesionale;
- 5- Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit;

Fakulteti i Studimeve Profesionale funksionon bazuar në filozofinë me të ashtuquajtura “community college” (kolegje komunitare) nga eksperiencia e vendeve anglo-saksone, ofron diploma të fokusuara më së shumti në profesione praktike të kërkuara dhe frymëzuar nga tregu i punës. Aktualisht Fakulteti i Studimeve të Integruara me praktikën ka kaluar si njësi bazë pranë Fakultetit të Studimeve Profesionale me urdhër nr. 110 datë 25.05.2021 të MASR.



ORGANIZIMI I INSTITUCIONIT

Baza ligjore dhe Autonomia në organizimin e brendshëm

Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës është krijuar me VKM Nr. 801, dt 20.12.2005 “Për hapjen e Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës”, si një Institucion Publik i Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor. Universiteti ka një statut të miratuar nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës në Maj të vitit 2011. Ai mbështetet në Ligjin Nr. 80, dt 22.07.2015, (në vijim LAL) në aktet nënligjore të bazuara në të, si dhe legjislacionin ekzistues në fuqi. Statuti është në përputhje të plotë me misionin dhe qëllimet e universitetit, sipas të cilave UAMD të gjithë veprimtarinë e tij synon në mënyrë të vazhdueshme të arrijë standardet akademike më të larta bashkëkohore kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe të përkrahë aspiratat arsimore dhe arritjet e cilitdo që kërkon të përfitojë nga arsimi i lartë. Statutit i nënshtrohen të gjitha njësitë dhe strukturat organizative dhe mësimore shkencore të Universitetit.

Institucioni disponon rregulloren e tij të brendshme, e cila ka për qëllim rregullimin e veprimtarisë mësimore-shkencore dhe administrative të Universitetit në përputhje me objektivat dhe misionin ligjor të tij. Ajo i shtrin efektet e saj në të gjitha strukturat, organet dhe autoritetet drejtuese, njësitë përbërëse, personelin akademik, personelin ndihmës mësimor-shkencor, personelin administrativ, studentët, etj.

Në rishikimin dhe përmirësimin e rregullores përfshihen aktorë të ndryshëm institucionalë nga njësitë respektive, por edhe përfaqësuesit e studentëve. Mënyra se si bëhet përmirësimi dhe rishikimi i kuadrit rregullator brenda UAMD është një indikator pozitiv për mirëfunksionimin institucional.

Strukturat administrative dhe akademike sigurojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë menaxheriale dhe akademike të Universitetit. Organet kolegjiale të zgjedhura funksionojnë, sipas statutit dhe mundësojnë diskutimet, debatet dhe marrjen e vendimeve në formë gjithëpërfshirëse. Institucioni e kryen rregullisht procesin e informimit publik përmes faqes zyrtare të internetit, si dhe raportit vjetor, i cili pasqyron gjerësisht veprimtarinë akademiko-shkencore dhe administrative të tij i cili bëhet publik çdo fundviti, sipas Udhëzimit të Ministrit Përgjegjës të Arsimit, brenda afateve të caktuara dhe strukturës që duhet të përmbajë raportin.

UAMD bashkëpunon me organizma të tjerë nga sektori publik dhe ai privat në mbështetje të studentëve për praktikat e tyre mësimore. UAMD është pjesë e programeve të mobilitetit të studentëve dhe stafit në kuadër të partneriteteve ndërkombëtare, Institucioni ka Planin e Zhvillimit Strategjik afatgjatë me objektiva dhe tregues të qartë mbi të cilin mbështeten politikat e përmirësimit të cilësisë.

Institucioni është bazuar gjithashtu në Planin e Zhvillimit Strategjik për periudhën 2020 – 2025 . Plani përcakton qartë objektivat e synuar, strategjitë për arritjen e tyre si dhe treguesit e performancës. Pjesa më e madhe e rezultateve të performancës dhe objektiveve të strategjisë pasqyrohen gjatë diskutimeve dhe publikimit të Raportit Vjetor mbi Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore dhe financiare të Institucionit çdo fundviti mes drejtuesve të institucionit, stafit akademik, studentëve dhe të ftuarve të tjerë të jashtëm.⁴

Plani i Zhvillimit për periudhën 2020-2025, vë në dukje ato tematika që kanë nevojë të rishikohen,

²V.K.M. Nr. 801, datë 20 dhjetor 2005

³Rregullorja e UAMD

⁴Planin e Zhvillimit Strategjik për periudhën 2020 – 2025

duke analizuar së pari arritjet e deritanishme, çështjet e parealizuara, si dhe duke e diskutuar në tryeza të rrumbullakëta me aktorët përkatës siç edhe është shndërruar në një praktikë shumë pozitive në UAMD.

Ajo do të përshtatet me sfidat aktuale në fushën e arsimit të lartë, legjislacionin e ri, si dhe ndryshimet në mjedisin e brendshëm dhe të jashtëm të Institucioneve të Arsimit të Lartë. Për të përmbushur detyrimet e ndryshme administrative UAMD, bazuar në organigramën e saj, është e organizuar në drejtori, sektorë dhe degë, kurse nga aspekti akademik në Njësi Kryesore dhe Njësi Bazë. Gjithashtu ekzistojnë edhe njësi të tjera ndihmëse me karakter akademik dhe karakter administrativ, të cilat veprojnë në nivel Rektorati dhe Njesie Kryesore. Pranë Rektorit, kryejnë një rol të rëndësishëm administrativ edhe tre zëvendësrektorë, të cilët janë përgjegjës përkatësisht për: kërkimin shkencor, fushën mësimore dhe atë institucionale.

Përfaqësimi i studentëve në Senatin Akademik dhe në organe të tjera kolegiale të zgjedhura garantohej në çdo rast dhe pjesëmarrja është dinjitoze dhe frytdhënëse. Institucionit ka ngritur edhe qendra me karakter mësimor-shkencor dhe kërkimor:

- Qendra për Zhvillim dhe Ekselencë (QZHE);
- Qendra për Edukimin në Vazhdim (QEV)
- Qendra e Trashëgimisë Kulturore Mesjetare (QTKM)

QZHE funksionon si një strukturë që përfshin të gjitha njësitë kryesore dhe bazë të fakulteteve. Qëllimi i saj është nxitja, mbështetja, organizimi, koordinimi, monitorimi dhe vlerësimi i veprimtarisë për kërkimin shkencor, ekselencë dhe zhvillim. Qendra është përgjegjëse për botimin e revistës shkencore të Universitetit “ Interdisciplinary Journal of Research and Development” e lancuar për herë të parë në vitin 2013.

QEV është njësi bazë e veçantë në strukturën akademike të UAMD në varësi të Fakultetit të Edukimit dhe funksionon në bazë të rregullores së brendshme të saj.⁵ Aktivitetet kryesore të cilat zhvillohen përmes kësaj qendre janë trajnimet e mësuesve të arsimit parauniversitar sipas foramtit të përcaktuar nga MASR. QEV funksionon si qendër kërkimore dhe e publikimeve të studimeve shkencore në fushën e edukimit.

QTKM është një qendër kërkimore-shkencore pranë Universitetit “Aleksandër Moisiu” në Durrës. Qendra është krijuar me vendim nr .15, 13.10.2016 të Këshillit të Administrimit, UAMD. Qendra nëpërmjet kombinimit të disa drejtimeve si arkeologjia dhe historia, trashëgimia materiale dhe shpirtërore, por edhe turizmi kulturor dhe historia e artit, përpiqet të kërkojë, organizojë projekte, publikojë rezultatet dhe të kthehet në një hapësirë të shkëmbimit të mendimeve midis fakulteteve të ndryshme të universitetit. Sigurisht që Qendra synon që të ndërveprojë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar me qëllim arritjen e bashkëpunimeve në avancimin e studimit të vlerave dhe mbrojtjes së trashëgimisë kulturore.

QENDRA PËR ZHVILLIMIN E TRASHËGIMISË ANTIKO MESJETARE SHQIPTARE



Dr. Ols Lafe , Drejtor i Qendrës për Zhvillimin e Trashëgimisë Antiko Mesjetare Shqiptare , i ftuar nga Departamenti i Shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në bashkëpunim me programin International Visitor Leadership Program (IVLP) dhe organizatën Gulf Coast Diplomacy , zhvilloi një bisedë me grupimin e Diplomatëve të Rinj të shtetit të Florida - s . Dr. Lafe si një pjesëmarrës gjatë vitit 2012 në programin IVLP dhe Qytetar Nderi i Pensacola (Florida) , për shkak të kufizimit të udhëtimeve ndërkombëtare zhvilloi online një bisedë të hapur dhe me shumë ilustrime , me fokus Shqipërinë dhe arkeologjinë e saj , por edhe turizmin , gjuhën dhe diversitetin kulturor . Pyetjet e të rinjve të cilët më përpara kishin informacione vetëm gjeografike për Shqipërinë , u përqëndruan në prezantimin e potencialit arkeologjik dhe turistik të vendit por edhe për të ardhmen Europiane të saj.

Gjatë vitit akademik 2021-2022 qendra ka vijuar aktivitetin shkencor dhe kontaktet me universitete e qendra kërkimore-shkencore në vendet e BE për të realizuar marrëveshje në kuadër me UAMD të cilat më pas mund të aktivizohen specifikisht nëpërmjet projekteve kërkimore-shkencore në varësi të hapësirave buxhetore.Më konkretisht, qendra nëpërmjet komunikimit e vazhdueshëm dhe mbështetjen e Rektoratit ka arritur të ndërmjetësojë firmosjen e marrëveshjeve, organizimin e aktiviteteve në terren si dhe pjesëmarrjen në konferenca e leksione të hapura si vijon:

A. Marrëveshje bashkëpunimi


1. Marrëveshje bashkëpunimi mes UAMD dhe Institute of Archaeology of the Czech Academy of Sciences, Brno (1.11.2021)
2. Marrëveshje bashkëpunimi mes UAMD dhe Masaryk University, Faculty of Arts, Brno, Czech Republic (6.6.2022)

B. Projekte

1. Projekti kërkimor-shkencor “Varret shkëmbore të Matit” dhe territori i tyre - studime arkeologjike në pellgun ujëmbledhës të lumit të Matit (miratuar në Ministrinë e Kulturës, Kulturës, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, Vendim nr.104 datë 19.4.2022)

C. Prezantime në konferenca, leksione të hapura

1. In situ apo ex situ: një analizë e arkeologjisë urbane në Durrës gjatë 100 viteve të fundit, Konferenca Shkencore Qendrat e banuara të Shqipërisë-gjendja dhe e ardhmja, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan, Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Elbasan 17 Dhjetor 2021.
2. Arkeologjia urbane në Durrës – problemet dhe e ardhmja, Universiteti Polis, 20 Janar 2022
3. Contract archaeology in Albania: between tradition and innovation, presented at American Institute for Southeast European Studies (AISEES), February 9, 2022
4. Sacred Landscapes of a World Heritage City: The Case of Berat, in Conservation of Architectural Heritage IEREK International Conference 6th Edition, Palermo 25-27 May 2022, J. Dhiamandi, O. Lafe, A. Miller and R. Mazari.



D. Botime

1. në proces botimi Tafilica, Z., Baze, E. and Lafe, O. Chapter 4: Historical Background, in Archaeological Investigations in a Northern Albanian Province: Results of the Projekti Arkeologjik i Shkodrës (PASH).
2. në proces botimi Lafe. O., Gjuraj, Gj., Mazari, R. Raport i gërmimit arkeologjik të shpëtimit në zonën arkeologjike B të Parkut të Finiqit, in CANDAVIA 9, Akademia e Studimeve Albanologjike.
3. në proces botimi Lafe, O., Xheka, E. Raport mbi gjetjen e një fragmenti kolektori në lagjen Goricë (Berat), në Revista Arkeologjike, Ministria e Kulturës.

QENDRA PËR EDUKIM NË VAZHDIM

Qendra për Edukim në Vazhdim është një prej gjashtë njësive bazë të Fakultetit të Edukimit. QEV është njësia bazë më e re në Fakultetin e Edukimit. Ajo në vitin akademik 2017 – 2018 plotëson të gjitha kriteret e parashikuara në Nenin 26 të Ligjit për Arsimin e Lartë dhe të Statutit të UAMD.

Në vëmendjen e anëtarëve të QEV është puna intensive dhe e përgjegjshme në drejtim të kujdesit ndaj studentit dhe krijimin e mundësive të tyre për të marrë informacionin e duhur dhe krijimit të mundësive për të shprehur talentet, idetë dhe fjalën e tyre të lirë.

Gjatë vitit akademik 2021-2022 QEV zhvilloi veprimtarite në përputhje me planin vjetor të miratuar në dekanatin e FE, ku do të vecojmë:

1. U zhvilluan tranimet me mësuesit e sistemit parauniversitar, ku u certifikuan rreth 2500 mijë mësues nga gjithë vendi.
2. U hartuan modulet e reja të trajnimeve për mësuesit e sistemit parauniversitar, të cilat u akredituan deri në vitin 2026.
3. U zhvilluan trajnimet e brëndeshme në kuader të rritjes së kapaciteteve akademike dhe aftësive pedagogjike të stafit të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës.
4. U zhvillua Forumi i Mësuesve, shoqëruar me botimin përkates, aktivitet ky i përvitshëm.
5. Pjesëmarrja e anëtarëve të QEV në grupet e punës të disa projekteve të Erasmus +.

Për vitin akademik 2022-2023, parashikojmë të vijojmë aktivitetet tona:

1. Trajnimet me mësuesit e sistemit parauniversitar, duke rritur numrin e moduleve të trajnimeve të ofruara, si rrjedhojë duke rritur dhe numrin e mësuesve të trajnuar.
2. Trajnimin e rritjes së kapaciteteve akademike dhe aftësive pedagogjike të stafit të UAMD, duke shtuar këtu dhe modulet për "sipërmarrjen" që do të përfshijë grupet target mësues, staf akademik dhe studente në kuadrin të projektit Erasmus + Entral.
3. Vijimi i aktivitetit të Forumit të Mësuesve i cili zhvillohet çdo vit.
4. Puna e stafit të QEV për hartimin e programit të studimit Master Profesional "Oficere sigurie në institucionet arsimore", i cili synohet të miratohet dhe të hapet në vitin e ardhshëm akademik.
5. Vijimin e aplikimeve në projekte të ndryshme të Erasmus +

AKTIVITETE TË QENDRËS PËR KËRKIM, ZHVILLIM DHE EKSELENCË

2021-2022

Qendra për Kërkim, Zhvillim dhe Ekselencë (QKZHE) është njësi kryesore në Universitet e cila ka për qëllim koordinimin e kërkimit shkencor për inovacion dhe zhvillim, në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës; nxitjen dhe mbështetjen e stafit akademik dhe komunitetit studentor për zhvillimin e kapaciteteve në kërkimin shkencor.

Qendra për Kërkim, Zhvillim dhe Ekselencë (QKZHE) ushtron aktivitetin e saj duke synuar realizimin e kërkimit shkencor si pjesë integrale e punëve të stafit akademik të UAMD-së dhe zhvillimin e bashkëpunimit me institucione dhe qendra të tjera kërkimore brenda dhe jashtë vendit, në interes të realizimit të kërkimit shkencor për inovacion e zhvillim, në përputhje me prioritetet strategjike për zhvillim demokratik e social-ekonomik të vendit.

Veprimtaria e QKZHE për vitin akademik 2021-2022

1. Nënshkrimi i Marrëveshjes së bashkëpunimit mes Qendrës pranë Universitetit La Sapienza, Romë “Inter-Department Research Center for the International Cooperation with Eurasia, Mediterranean, Sub-Saharan Africa” dhe Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës.

Kjo marrëveshje synon nxitjen e bashkëpunimit në fushën shkencore dhe akademike përmes shkëmbimit të studentëve të ciklit të tretë si dhe trajnim stafi akademik dhe administrativ mes dy Institucionesh. Njëkohësisht synohet forcimi i bashkëpunimit shkencor në fushën ndërkombëtare përmes promovimit të aktiviteteve të përbashkëta, seminareve, konferencave, publikimeve etj.

2. Nënshkrimi i Marrëveshjes së bashkëpunimit mes Qendrës së Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, Tiranë dhe Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës.

Qëllimi i marrëveshjes është të mundësojë bashkëpunimin mes palëve në identifikimin e iniciativave për promovimin dhe mbështetjen profesionale në mënyrë që të operojnë me efikasitet dhe produktivitet. Bashkëpunimi do të konsistojë në: nivel kurrikular dhe ekstrakurrikular lidhur me njohjen dhe përshtatjen e formave parandaluese dhe referuese të fenomenit/ve radikalizuese dhe ato të ekstremizmit të dhunshëm; kontribut në rritjen e ndërgjegjësimit të të rinjve mbi format e radikalizmit; nxitja, bashkëpunimi, mbështetja dhe organizimi i veprimtarive shkencore si konferenca, trajnime, seminare e botime me interes të dyanshëm; shkëmbimi i eksperiencave, praktikave dhe ekspertëve në nivel kombëtar dhe rajonal etj.

3. Nënshkrimi i Marrëveshjes së bashkëpunimit mes Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Tiranë dhe Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës.

Marrëveshja synon lehtësimin e marrëdhënieve ndër-institucionale për bashkëpunimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve të palëve, me qëllim komunikimin dhe shkëmbimin e personelit akademik, studentëve, informacioneve, ideve dhe eksperiencave që lidhen me fushat me interes të përbashkët. UAMD do të ftojë dhe mirëpresë përfaqësues nga komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi për të mbajtur leksione të hapura, workshope e seminare të ndryshme për studentë dhe lektorë rreth çështjeve me interes të përbashkët; njëkohësisht parashikohet zhvillimi i programeve hulumtuese, projekteve kërkimore-shkencore dhe projekte të tjera të cilat janë me interes të të dy Institucioneve.

4. Në kuadër të projektit “Forcimi i autonomisë universitare dhe rritja e llogaridhënies dhe transparencës së Universiteteve të Ballkanit Perëndimor (STAND)”, Qendra për Kërkim, Zhvillim dhe Ekselencë mori pjesë në seminarin me temë Autonomia Akademike në Institucionet e Arsimit të Lartë me prezantimin: “Autonomia akademike, një qasje dualise”. Qëllimi kryesor i STAND është forcimi i autonomisë së universiteteve dhe rritja e përgjegjësisë dhe transparencës së Universiteteve të Ballkanit Perëndimor. Projekti synon të përmirësojë proceset dhe mekanizmat e autonomisë së universitetit duke rritur kapacitetet menaxhuese, llogaridhënien dhe transparencën e Universiteteve të Ballkanit Perëndimor

5. Qendra për Kërkim, Zhvillim dhe Ekselencë koordinoi dhe organizoi pjesëmarrjen e Universitetit “Aleksandër Moisiu” në “Panairin mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor” i cili u zhvillua për herë të parë, në kuadër të vitit jubilar të 50-vjetorit të themelimit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë si nismë e përbashkët e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Qëllimi i panairit ishte që të bënte të njohura arritjet më cilësore në botimet akademike, shkencore dhe universitare. UAMD u përfaqësua në këtë panair në stendën e tij me rreth 30 tituj botimesh shkencore të stafit akademik ku njëkohësisht u promovua dhe monografia me titull “Mendimi juridik i shqiptarëve ndër shekuj”, me autor Prof. Asc. Dr. Eugen Pepa.

6. Qendra për Kërkim, Zhvillim dhe Ekselencë në kuadër të thirrjeve Horizon Europe, koordinoi dhe mundësoi përfshirjen si partner në Konsorciumin e përbërë nga 7 partnerë të Universiteteve dhe Qendrave Kërkimore europiane me Koordinator Universitetin e Spanjës UDEUSTO. Në projektin e aplikuar “POETRY Call: HORIZON-CL2-2022 — TRANSFORMATIONS-01-05: Gender and social, economic and cultural empowerment” u përfshinë dy pedagoge nga fakulteti i Biznesit dhe një pedagoge nga fakulteti i Edukimit i UAMD-së. Projekti u vlerësua dhe u rendit mirë, por nuk iu dha financimi dhe mbetet në listën e rezervave të financimit.

Në këndvështrimin financiar UAMD gëzon një stabilitet të provuar ndër vite. Bordi i Administrimit është organ kolegjal vendimmarrës që mbikqyr dhe kontrollon veprimtarinë e UAMD-së në aspektet administrative, financiare dhe ekonomike, si dhe në ushtrimin e mbrojtjes së të drejtave të pronësisë publike të UAMD-së, në të cilin marrin pjesë përfaqësues të Institucionit dhe të financuesve kryesor të Institucionit ⁶



Krahas Rektorit që është autoriteti më i lartë akademik, përmendet edhe roli i administratorit, i cili përfaqëson autoritetin më të lartë administrativ dhe është përgjegjës për mirëfunksionimin financiar të UAMD-së. Ai është përfaqësuesi ligjor i institucionit për çështjet financiare dhe administrative sipas përcaktimeve të ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015 në Republikën e Shqipërisë.

Bashkëpunimi me komunitetin e qytetit

Universiteti është pjesë e qytetit dhe dëshiron të kontribuojë më shumë për komunitetin vendor. Së bashku me komunitetin e qytetit, jo vetëm që do të lidhim më mire Universitetin me tregun e punës, por edhe do të njohim trendin dhe nevojat specifike në mënyrë që të përmirësojmë kurrikulat e studimit dhe mendimit shkencor në UAMD.

UAMD ka një zyrë specifike për monitorimin dhe ndjekjen e vazhdueshme të punësimit të të diplomuarve të tij nëpërmjet Sektorit të Karrierës, Alumni dhe Komunikim (KAK). Ky monitorim kryhet duke dërguar periodikisht formularin për t'u plotësuar online nga studentët e diplomuar në adresat e tyre të e-mail përmes të cilës mblidhen informacione mbi punësimin e tyre. Duke u bazur te mbledhja dhe përpunimi i informacionit të mbledhur, rezulton se punësimi i studentëve të diplomuar në UAMD, jo gjithmonë përkon ose është në një linjë, me fushën për të cilën studentët kanë marrë formimin përkatës dhe janë diplomuar.

Në kuadër të bashkëpunimit me komunitetin Sektori për Karrierën dhe Alumni zhvilloi një Webinar me temë: "Përgatitja për jetëshkrimin, letrën e motivimit dhe procesin e intervistës".

Ky Webinar u zhvillua në tre faza trajnimi, përkatësisht në datat 15-17-22 Qershor 2021 dhe kishte në fokus të tij përgatitjen e jetëshkrimit, letrës së motivimit dhe kalimin me sukses të intervistës së punës. Përgjatë këtyre fazave trajnuese mbi 100 studentë mësuan mbi shkrimin e një CV-je fituese, hartimin profesional të letrës së tyre të motivimit, kalimin me sukses të një interviste pune dhe krijimin e dosjes së karrierës.

Gjithashtu në vazhdimësinë e bashkëpunimit me komunitetin u organizua për herë të parë në Universitetin "Aleksandër Moisiu" në Durrës, "Panairi i Punës dhe Karrierës".



Ndërkombëtarizimi dhe Partneritetet Projektet

Drejtoria e Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë, gjatë vitit akademik 2021-2022 ka vepruar në vazhdimësi në zbatim të objektivave strategjikë të “Strategjisë së Ndërkombëtarizimit 2021-2022”.

Në kuadër të përmbushjes së objektivit të parë strategjik “Ndërkombëtarizimi i programeve të studimit përmes organizimit të diplomave të përbashkëta dhe/apo të dyfishta me universitetet partnere. UAMD pas një pune intensive finalizoi hapjen e programeve për diploma të përbashkëta në të tre ciklet e studimit, me universitetet si më poshtë:

1. Universitetin “La Sapienza” në Romë: Diplomë e dyfishtë në ciklin e parë të studimeve, Bachelor në “Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik”.
2. Universitetin Pedagogjik të Krakovit, Poloni: Diplomë e dyfishtë në ciklin e tretë të studimeve, Doktoratë në “Shkenca Edukimi”.
3. Universitetin Cote d’Azur, Nicë, Francë: Diplomë e dyfishtë në ciklin e dytë të studimeve Master Shkencor në “Administrim Publik”.



(Figura Nr.1 dhe Figura Nr.2 Në kuadër të diplomave të dyfishta me universitetet partnere)

Marrëveshjet në kuadër të Credit Mobility

Universiteti gjatë periudhës 2021-2022 ka lidhur 13 (trembëdhjetë) marrëveshje të reja ndër-institucionale KA1 Erasmus +, për mobilitin studentor dhe të stafit akademik dhe administrativ:

1. Universiteti i Split, Kroaci;
2. Universiteti Leonardo da Vinci, Francë;
3. Universiteti i Seviljes, Spanjë;
4. Universiteti i Leon, Spanjë;
5. Universiteti HSSE Plovdiv, Bullgari;
6. Universiteti Koblenz, Gjermani;
7. Universiteti La Sapienza, Itali;
8. Universiteti Yildiz Technical, Turqi;
9. University of Agricultural Sciences and Veterinary Medicine "King Michael I of Romania", Rumani;
10. Universiteti Sopot, Poloni;
11. Universiteti A Coruna, Spanjë;
12. Universiteti Rey Juan Carlos, Madrid, Spanjë;
13. Universiteti HWR Berlin, Gjermani;
14. Universiteti i Studimeve G'Annunzio Chieti, Pescara
15. Universiteti Liege, Belgjike;
16. Universiteti i Palermos, Itali



PARTNERITETET

Gjate vitit akademik 2021-2022, UAMD ka patur një rritje të ndjeshme të studentëve të cilët kanë përfituar nga shkëmbimet në universitetet partnere europiane.

Përgjatë semestrit të dytë të vitit akademik 2021-2022 janë duke përfituar nga bursë e plotë studimi **52 studentë** në universitete të vendeve të BE-së si Spanjë, Gjermani, Francë, Letoni, ndërsa semestrin e parë janë planifikuar të përfitojnë nga shkëmbimet **21 studentë**.

Sa i takon shkëmbimeve të stafit akademik, gjatë këtij viti, kanë përfunduar shkëmbimet **124 staf akademik** dhe **21 staf administrativ**.

➤ Rritjes së numrit të studentëve të huaj që studiojnë në këtë universitet;

Një student i huaj nga Universiteti i Anadolloyt, Turqi i nivelit Bachelor dhe **dy studentë** nga Universiteti i Vigo, Spanjë të nivelit Bachelor dhe Doktoraturë, janë akomoduar pranë Fakultetit të Biznesit.

Marrëveshjet e Bashkëpunimit

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës ka nënshkruar ndër vite rreth 157 marrëveshje të ndryshme bashkëpunimi ndër-institucionale dhe memorandume mirëkuptimi me institucionet e arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit.

Vetëm përgjatë vitit 2021-2022 janë nënshkruar rreth 40 Marrëveshje Bashkëpunimi. Këto bashkëpunime/marrëveshje/memorandume mundësojnë krijimin e rrjeteve të forta ndërkombëtare, zhvillimin e karrierës së studentëve, mbështetjen e zhvillimit profesional të stafit akademik dhe atij administrativ, zgjerimin e bashkëpunimit në promovimin e projekteve përkatëse, ofrimin e mundësive të larmishme përmes partneriteteve strategjike, dhe e fundit, por jo më pak e rëndësishme mundëson që stafi dhe studentët të zhvillohen profesionalisht.

Zhvillimi i bashkëpunimit dhe nxitja e partneriteteve në nivel ndërkombëtar është finalizuar me nënshkrimin e 25 marrëveshjeve ndërsa në rang kombëtar janë nënshkruar 15 marrëveshje vetëm gjatë vitit 2021-22. Për gjatë vitit 2021-22 janë rinovuar rreth 7 marrëveshje bashkëpunimi të cilave u kishin kaluar afatet e nënshkrimit të mëparshëm dhe janë në fazë rinovimi rreth 10 të tjera.

• **Marrëveshjet e nënshkruara në nivel Kombëtar për gjatë 2021-2022:**

1	Tiranë, Shqipëri	Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale
2	Durrës, Shqipëri	Kompania Work Safety Group
3	Tiranë, Shqipëri	F.B- WVP Fund Management
4	Tiranë, Shqipëri	Universiteti i Sporteve
5	Tiranë Shqipëri	Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza
6	Tiranë, Shqipëri	Akademia Shqiptare e Arteve dhe Shkencës
7	Tiranë, Shqipëri	Shoqëria abcons sh.p.k
8	Tiranë, Shqipëri	F.B--Shoqata e Siguruesve Shqiptar
9	Tiranë, Shqipëri	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave
10	Durrës Shqipëri	Autoriteti Portual-Instituti për bpunim dhe Zhvillim
11	Tiranë, Shqipëri	Shoqëria Alcoders
12	Tiranë, Shqipëri	Instituti Shqiptar për Studime Ligjore dhe Territoriale ALTRI
13	Tiranë, Shqipëri	Enti Rregullator I Energjitikes
14	Tiranë, Shqipëri	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
15	Tiranë, Shqipëri	AADF Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për zhvillim

• **Marrëveshjet e nënshkruara në nivel ndërkombëtar për gjatë 2021-2022:**

1	Romë, Itali	Centro di ricerca e cooperazione col Eurasia, Mediterraneo e Africa La sapienza
2	Punjab, India	Lovely Professional University
3	Delhi, India	Universiteti i Delhit
4	Turqi	Marmara University
5	Ankara, Turqi	Middle East Technical University
6	Rijeka, Kroaci	FSP- Fakulteti I Mjekesise
7	Rijeka, Kroaci	FSP- Fakulteti I Studimeve Detare
8	Uliege, Belgjikë	Universite de Liege

9	Messina Itali	Universiteti i Mesines
10	Tiranë, Shqipëri	Shoqëria Alcoders
11	Brno, Çeki	Instituti i Arkeologjisë e Akademise se Shkencave
12	Turqi	Altinbas University
13	Sarajeve, Bosnia-Herzegovina	Universiteti I Sarajeves
14	Ioannina, Greqi	Universiteti I Janines
15	Tbilisi, Georgia	Ivane Javakhishvili Tbilisi State University
16	Republic of Moldava	Tiraspol State University
17	Riga Latvia	Riga Technical University
18	Kosovë	Alma Mater Campus Rezonanca
19	Romë, Itali	Istituto Diplomatico Internazionale
20	Shkup Maqedoni	Ss. Cyril University
21	Pejë, Kosovë	Universiteti Haxhi Zeka
22	Prishtinë Kosovë	Universiteti I Biznesit dhe Teknologjise
23	Brno, Çeki	Masaryk University Fakulteti I Arteve
24	Georgi	Caucasus University
25	Vercelli, Itali	Universita del Piemonte Orientale

PROJEKTET

Me qëllim përmbushjen e objektivit strategjik “Rritja e numrit dhe cilësisë së zbatimit të projekteve zhvillimore, në fushën e kërkimit shkencor, teknologjisë, inovacionit dhe transferimit të teknologjive”,

UAMD është i angazhuar intensivisht në aplikimin dhe zbatimin e projekteve që lidhen me rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor dhe inovacionit për arsimin e lartë, projekte që targetojnë zhvillimin e kapaciteteve të stafit akademik, mobilitetin e pedagogëve dhe studentëve pranë universiteteve të huaja, organizimin e konferencave shkencore të përbashkëta, përkthime e botime akademike e pedagogji kenga autorë të njohur ndërkombëtarisht në bashkëpunim me stafin lokal, si dhe pajisjen e mjedise vëmësimore dhe laboratorëve.

Në thirrjet e vitit akademik 2021-2022, UAMD rezultoi fituese në 4 projekte të huaja me financim të Komisionit European si më poshtë:

Nr	Programi	Institucion koordinator	Titulli projektit
1	Erasmus+ CBHE	Universiteti i Mitrovicës Kosovë	Partneritet për Promovimin dhe Popullarizimin e Lëvizshmërisë Elektrike përmes Transformimit dhe Modernizimit të Programeve të Studimit të IAL-ve të vendeve të Ballkanit Perëndimor (PELMOB).
2	Erasmus+ CBHE	Universiteti Democritus i Thrakisë, Greqi	Përmirësimi i Menaxhimit dhe Qeverisjes përmes Mësimdhënies (MAGNET)
3	Erasmus+ CBHE	Universiteti i Tuscias, Itali	Kurse të arsimit të lartë në Gazetari të të dhënave në vende të Ballkanit Perëndimor (WEBJOU)
4	Erasmus+ CBHE	Technical University of Sofia, Bulgaria	IoT Green Transformation for Academic Society and Business Oriented Ecosystem in Western Balkans (IoT-ECO)

Gjithashtu gjate vitit akademik 2021-2022 UAMD rezultoi fitues në tre projekte të diplomave të dyfishta në kuadër të ndërkombëtarizimit financiar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit:

1. Diplomë e dyfishtë në ciklin e tretë të studimeve, Doktoratë në “Shkenca Edukimi” Universiteti Pedagogjik i Krakovit, Krakov, Poloni;
2. Diplomë e dyfishtë në ciklin e dytë të studimeve, Master Shkencor në “Administrim Publik” Universiteti Côte d'Azur, Nicë, Francë;
3. Diplomë e dyfishtë në ciklin e parë të studimeve, Bachelor në “Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik” Universiteti La Sapienza, Romë, Itali.

Më datë 29 Shtator 2022 u organizua event i çeljes së projekteve të diplomave të dyfishta me institucione të arsimit të lartë të vendeve të BE-së. në kuadër të ndërkombëtarizimit financiar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.

Të ftuar ishin edhe përfaqësues nga Universitetet partnere si Prof. Christian Vallar, Ish-Dekan dhe Profesor i së Drejtës në Universitetin Côte d'Azur (online) , Prof. Marco Cilento nga Departamenti i komunikimit dhe kërkimit social në Universitetin La Sapienza si edhe Dr. Kinga Orzeł-Dereń, përfaqësuese e Institutit të Arsimit parashkollor dhe fillor në Universitetin Pedagogjik të Krakovit. UAMD rezultoi fituese në thirrjen e vitit 2022 për Projektet Kombëtare të Kërkimit dhe të Zhvillimit (pkkzh) në projektin me titull “Pëgatitja, pilotimi dhe aftësimi i aktorëve vendorë mbi zbatimin e Metodologjisë për Vlerësimin e Ndikimit Barazisë Gjinore dhe rekomandimet e OBP-së [ILO] për Punën e Denjë në Shqipëri” në fushën e Shkencave Sociale dhe Albanologjike” Ndërkohë, ka vijuar procesi për implementimin e projekteve që po zbatohen aktualisht në UAMD konkretisht për projektet: ENTRAL, QUADIC, KALCEA, STAND, IDEA, ENGINE, U-SIA, MEPM, TTO4FOOD, Value- X, CBHE Erasmus + ku UAMD është institucion partner dhe VTECH@WBUni ku UAMD është lider.

Këto projekte iu mundësojnë universiteteve shqiptare të modernizojnë metodat e mësimdhënies, të krijojnë programe të reja studimi ose të përmirësojnë programet eksistuese duke i harmonizuar me ato të vendeve të zhvilluara të BE-së, të trajnojnë stafet akademike, të përmirësojnë laboratorët, të krijojnë ose të përmirësojnë shërbimet për studentët, për sigurimin e brendshëm të cilësisë etj.

RESURSET E INSTITUCIONIT

Menaxhimi i Burimeve Njerëzore

UAMD përmbush plotësisht detyrimet ligjore për plotësimin e njësive bazë me staf akademik me grada e tituj. Institucioni publikon në faqen zyrtare të internetit organigramën. Ai ndjek procedurë transparente të rekrutimit të stafit akademik dhe jo akademik në përputhje me Rregulloren (nenet 26, 27, 28) dhe Statutin e Universitetit (neni 33), dhe të akteve të tjera nënligjore.

Personeli akademik i UAMD klasifikohet në 3 kategori : Profesorë, Lektorë dhe Asistent-lektorë. Duhet theksuar se në rastet e stafit akademik efektiv që nuk kanë fituar gradën Dr. vetë institucioni i ka mundësuar trajnime efektive pranë Qendrës për Edukim në Vazhdim. Në rekrutimin e stafit akademik me kontratë vihet re një rritje e profesionalizmit të kandidatëve që tregon dhe reputacionin e mirë që Institucioni ka krijuar .Vlen për të përmendur gjithashtu një ulje në raportin staf akademik-studentë për m2. Ky reduktim vjen si pasojë e rritjes së numrit të stafit akademik, por edhe aktivizimit të godinës së re në Kampusin e Universitetit. Për vitin akademik 2021-2022, rezultojnë të punësuar për të dy semestrat përkatësisht, 306 personel akademik me kohë të plotë dhe 332 personel akademik me kohë të pjesshme.

Aktualisht UAMD ka 306 të punësuar si personel akademik nga të cilët 71 të kategorisë Asistent Lektorë, 175 Lektorë dhe 48 Profesorë i Asociuar dhe 12 Profesor Doktor. Personeli akademik i kategorisë asistent lektor janë të punësuar me kontratë me afat të caktuar, personeli akademik i kategorive lektor dhe profesor janë të punësuar me kontratë pa afat.UAMD ka të punësuar personel ndihmës-akademik me karakter teknik (laborantë) 10 persona, personel administrativ me karakter ndihmës-akademik 47 persona dhe personel administrativ më shumë se 100 persona.UAMD ndjek një politikë integruese dhe ndërkombëtarizuese për personelin dhe studentët e tij. Personeli akademik dhe administrativ ka qenë pjesë e shkëmbimeve të komponentit të mobiliteteve duke sjellë në institucion përfitime profesionale dhe duke zgjeruar rrjetin e bashkëpunimeve si rrjedhojë e këtyre mobiliteteve, numri i stafit akademik që ëshërë angazhuar në projektet e financuara nga BE (ERASMUS+) është (124) dhe implementimi i mobiliteteve ka filluar në 2021. Risi është gjithashtu krijimi i një mekanizmi vlerësimi të vazhdueshëm e periodik për personelin në përputhje me rregulloren e UAMD, mekanizëm ky i organizuar në tre nivele të cilat përfshihen në Raportin Vjetor të Vlerësimit.

Studentët gjithashtu janë pjesë e vlerësimit të personelit akademik. Çdo vit studentëve iu shpërndahen pyetësorë nga Drejtoria e Kurrikulave dhe Standardeve të Cilësisë, lidhur me performancën e personelit akademik. Pyetësorët plotësohen në mungesë të personelit akademik dhe ruajnë anonimin e studentit. Rezultatet e anketimit nga studentët pasqyrohen në Raportin e Performancës së Personelit Akademik.

KURRIKULA

Programet e studimit të ofruara nga UAMD janë në përputhje me misionin e UAMD , si dhe në përputhje me misionin e Njësive Kryesore ku ofrohen këto programe studimi të pasqyruar në rregulloret e brendshme të këtyre njësive. Përputhja e programeve të studimit me misionin e Njësive Kryesore të UAMD-së kontrollohet që në aplikimin e hapjes së programit të studimit, fillimisht nga Njësiti Bazë dhe ato Kryesore dhe më pas nga Senati Akademik. Kapacitetet infrastrukturore verifikohen çdo fillim viti akademik nga Ministria përgjegjëse për Arsimin gjatë miratimit të kuotave për çdo program studimi. Gjithashtu këto kërkesa monitorohen në mënyrë të vazhdueshme edhe nga komisioni i përhershëm për garantimin e standarteve dhe cilësisë.

UAMD siguron informim publik të ofertës akademike nëpërmjet zyrave përgjegjëse dhe paraqitet në mënyrë të përditësuar në faqen zyrtare.

Aktualisht UAMD ofron 97 programe studimi, 16 prej të cilave të hapura dhe të riorganizuara në 5 vitet e fundit. Në UAMD aktualisht ofrohen 18 programe me karakter profesional (2 vjeçar), 35 programe të ciklit të parë bachelor, 44 programe të ciklit të dytë (25 profesional dhe 19 shkencor), 1 program të ciklit të tretë pranë FB dhe pranë FE. UAMD mundëson që programet e studimit të ciklit të dytë të ndiqen edhe nga studentë që janë në marrëdhënie pune. Për këtë objektiv janë krijuar kushtet e duhura infrastrukturore dhe kohore që studentët e programeve të ciklit të dytë ti frekuentojnë këto programe në orare të përshtatshme që i mundësojnë vazhdimin e marrëdhënies së punës gjatë kohëzgjatjes së studimeve.

Në vitin akademik 2021-2022 janë hapur 2 programe të reja bachelor në Fakultetin e Biznesit dhe 7 programe ofrohen edhe në gjuhën angleze. Fakulteti i Edukimit është zgjeruar me 3 programe të reja, nga këto 2 janë programe master dhe 1 është bachelor. Në Fakultetin e Studimeve Profesionale janë hapur 4 programe të reja, 2 bachelor dhe 2 master me karakter profesional. Në Fakultetin e Shkencave Politike Juridike janë hapur 2 programe të reja të ciklit të dytë.

Për hapjen e programeve të reja të studimit, riorganizimin e programeve të studimit ekzistuese⁷

, përditësimin e tyre janë marrë në konsideratë objektivat kombëtarë e ndërkombëtarë të zhvillimit, si dhe janë realizuar studime tregu , me qëllim përmirësimin e ofertës akademike në funksion të ofrimit të një arsimi bashkëkohor dhe të plotësimit të nevojave të tregut të punës.

Nisur nga kriza e pandemisë dhe pasojat që u reflektuan në çdo aspekt të jetës, ashtu edhe në arsimin e lartë, UAMD ka aplikuar, ndër të tjera, për hapjen e programeve të reja lidhur me kujdesin shendetësor dhe menaxhimin e tij.

⁷Studime të tregut të punës në dosjet e riorganizimit ose në dosjet e reja të studimit.



20 Maj 2022 nga Marrëveshja UAMD-AADF në kuadër të programit (Research Expertise from Academic Diaspora)

Cilësia dhe fleksibiliteti i Kurrikulës

- Mundësimi dhe siguri për një përgatitje e formim cilësor teorik dhe praktik në përputhje me kërkesat e tregut.
- Organizimi i programeve të studimit me objektiva të përcaktuara qartë, bën të mundur që ato të jenë lehtësisht të kuptueshme dhe të arritshme.
- Ngarkesa mësimore e stafit akademik bëhet në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet nënligjore në fuqi.
- Vlerësimi dhe zhvillimi i politikave mbështetëse nga institucioni për ecurinë dhe mbarëvajtjen e studentëve.
- Organizimi i programeve akademike u mundëson studentëve të praktikojnë aftësitë teorike dhe të përgatiten për të qenë të aftë në tregun e punës.
- Mundësimi i vlerësimit cilësor të dijeve teorike dhe praktike të studentëve, nëpërmjet provimeve të ndërmjetme dhe përfundimtare dhe vlerësimi i praktikave të zhvilluara përgjatë fazave të kontrollit të dijeve, sipas një sistemi unik i ndërtuar dhe bazuar në eksperiencën e universiteteve amerikane.
- Cilësia e programeve të studimit dhe aplikimi që në hapje e Kartës së Bolonjës për mobilitetin e pedagogëve dhe studentëve, ka mundësuar ndër vite që shumica e ish studentëve të UAMD, të ushtrojnë profesionin dhe të japin kontributin e tyre në institucion, duke qenë pjesë e stafit akademik të Fakulteteve të Universitetit, si edhe në universitetet e tjera brenda vendit, ose të punojnë në institucione e kompani të ndryshme.

- Përdorimi i metodave interaktive dhe efektive, orientimi drejt risive dhe inovacionit në mësimdhënie e kërkimin shkencor, ka mundësuar krijimin e një qasje ndaj studenteve, duke i ndihmuar në mësimnxënie, në kuptimin konceptual të situatave komplekse me karakter ekonomik dhe jo vetëm, krijimin e aftësive krijuese për të gjeneruar ide të reja mbi teoritë, produktet, njohuritë etj.

-Studimi i tregut nga departamentet e fakulteteve të Universitetit, mundëson hapjen e programeve të reja të studimit, ashtu si dhe riorganizimin e atyre ekzistuese, për një përshtatje më të mirë ndaj kërkesave të tregut, si dhe do të ndikojë pozitivisht në preferencat e studentëve të të dy cikleve të para të studimit.

Të gjitha kurrikulat e UAMD për çdo cikël studimi mund të aksesohen në faqen web të Institucionit ose duke skanuar kodin në këtë faqe.



MËSIMDHËNIA DHE KËRKIMI SHKENCORË

Për të tretin vit radhazi për personelin akademik të Universitetit “Aleksandër Moisiu” janë aplikuar “Kriteret e vlerësimit të veprimtarisë kërkimore shkencore të personelit akademik dhe njësive të UAMD”. Këto kritere janë të miratuar në të gjitha nivelet dhe përfaqësojnë një listë treguesish të veprimtarisë kërkimore-shkencore të vendosur në një sistem pikëzimi.

Kriteret e vlerësimit janë përcaktuar dhe në objektivat e Kërkimit Shkencor dhe Veprimtarisë Kërkimore (2020-2025) në përgjigje të kërkesave të ligjit “Për Arsimin e lartë e kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH”, duke e konsideruar kërkimin shkencor si kriter i vlerësimit institucional, rankimit e financimit; për ta shndërruar UAMD-në, universitetin e dytë në Shqipëri, në një qendër të zhvillimit rajonal dhe (mbarë) kombëtar.

Kriteret vlerësimit të njësive bazë përfshijnë një listë treguesish që përlllogariten sipas kontributit katërvjeçar të njësive bazë në fushën e kërkimit shkencor, vlerësim i cili realizohet sipas një sistemi pikëzimi, të miratuar me urdhër të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

UAMD për zhvillimin e kërkimit shkencor nga ana e Njësive bazë të saj, respekton kriteret bazë⁸ për ashtu sic janë të njëjta si dhe për krijimin e baze kombëtare të të dhënave për kërkimin shkencor në sistemin e arsimit të lartë, të administruara dhe përditësuara nga AKKSHI-ja: a) listën e disertacioneve të doktoratave të mbrojtura dhe abstraktet përkatëse në një nga pesë gjuhët e Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht, italisht; b) listën e punimeve të diplomës së ciklit të dytë dhe të tretë, të mbrojtura, dhe abstraktet përkatëse në një nga pesë gjuhët e Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht, italisht; c) listën e përditësuar të kontributit shkencor të personelit akademik e kërkimor të institucioneve të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor dhe të personelit kërkimor të instituteve të tjera të kërkimzhvillimit.

Gama e gjërë e aktiviteteve që të gjithë fakultetet kanë zhvilluar gjatë vitit akademik 2021-2022, përfshin leksionet e hapura nga personalitete të njohur të ftuar nga fusha specifike, aktivitetet me karakter social, botime brënda dhe jashtë vendit, konferenca shkencore etj, ku vihet re një angazhim i lartë jo vetëm i pedagogëve që iniciojnë këto aktivitete, por edhe e pjesës tjetër të stafit akademik dhe vetë studentëve.

⁸LIGJ Nr. 80/2015 PËR ARSIMIN E LARTË DHE KËRKIMIN SHKENCOR NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, Neni 13 Baza kombëtare e të dhënave për kërkimin shkencor

Kontributet e njësive bazë të UAMD dhe personelit akademik të tij, vlerësohen në mënyrë të standardizuar për monitorimin në kohë reale të veprimtarisë kërkimore-shkencore, për vlerësimin periodik dhe rankimin e departamenteve dhe njësive të tjera bazë që përfshihen në vlerësimin institucional, në përputhje me kërkesat e ligjit 80/2015, si dhe akteve nënligjore, si:

- VKM nr. 165, datë 21.03.2018 “Për metodologjinë e procesit të vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësive bazë të institucioneve të arsimit të lartë”

- Udhëzim nr. 30, datë 30.12.2019 për disa ndryshime në udhëzimin nr. 17, datë 3.8.2016 “për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në republikën e shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara, jashtë vendit”, i ndryshuar.



(UAMD nderon me titullin “Doctor Honoris Causa” akademikun, Prof.Dr. Rexhep Qosja)

Revista ndërdisiplinare e kërkimit dhe zhvillimit (IJRD), është një revistë zyrtare ndërkombëtare e Universitetit “Aleksandër Moisiu” të Durrësit. IJRD është një revistë me hyrje të hapur që konsideron artikuj origjinal, përmbledhje dhe komunikime të shkurtra me standard të lartë shkencor në disipinat e ndryshme shkencore. Qëllimi i kësaj reviste është promovimi, shkëmbimi i informacionit dhe njohurive midis studiuesve, studentëve dhe stafit akademik. Revista shqyrton dorëshkrimet që plotësojnë kriteret e përgjithshme domethënese dhe përsosmërisë akademike. Të gjithë përdoruesit kanë të drejtë të hyjnë lirshëm në internet duke aksesuar të gjithë artikujt e botuar nga IJRD pa asnjë tarifë.

Kjo revistë publikohet në mënyrë periodike, cdo tre muaj, siguron një medium për botimin e kërkimeve origjinale nga spektri i plotë i shkencave, në fushat e : Shkencat Ekonomike; Shkencat Sociale dhe të Edukimit; Shkencat Politike Ligjore; Shkenca e natyrës; Shkencat e Aplikuara. Një fakt pozitiv është kërkesa në rritje për botime nga ana e personelit akademik (UAMD), fakt i cili sjell në vëmendje rëndësinë e publikimit të periodikëve të tjerë shkencorë, më të profilizuar, mundësisht sipas njësive kryesore të UAMD apo edhe njësive bazë (njëapo disa njësi). Në vijim të thirrjes së bërë “Për botimin e periodikëve shkencorë”, antarët e personelit akademik mund të shprehin interesin për të kontribuar në botimin e periodikëve shkencorë të UAMD (revista apo buletine shkencore), të indeksuara me ISSN ndërkombëtar, në përputhje me standardet e nevojshme për të qënë pjesë në listën e revistave shkencore të publikuara nga Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencore dhe Inovacionit, në muajin shkurt të çdo viti. Një element me rëndësi si tregues i rëndësishëm i performancës kërkimore-shkencore janë titujt dhe gradat shkencore të personelit akademik. Në tabelën vijuese (tabela 2), janë pasqyruar titujt dhe gradat shkencore të personelit akademik, sipas njësive bazë dhe njësive kryesore të UAMD.




Njësitë bazë të UAMD shfaqin interesat e tyre dhe specifikat e zhvillimit të kërkimit shkencor.


Këto të fundit i behen me dije Këshillit të Kërkimit Shkencor, si një organ vendimmarrës.

Duke kërkuar përfitim reciprok për universitetin, komunitetin dhe palët e interesit, UAMD kërkon të arrijë një pozitë të konsoliduar në fushën e kërkimit shkencor dhe inovacionit. Përfshirja e studentëve dhe partnerëve në këto procese, rrit njohjen dhe vlerësimin e ndërsjellë, si dhe mundëson vënien në zbatim të njohurive të fituara për zhvillimin e karrierës. Aktualisht UAMD ka 157 Marrëveshje Bashkëpunimi me institucione dhe kompani të ndryshme, nga këto 40 janë nënshkruar gjatë vitit akademik 2021-2022. Universiteti promovon shkëmbime afatshkurtra për stafin akademik dhe administrativ, si dhe shkëmbime semestrale për studentët në nivelin Bachelor dhe Master me Institucione të Arsimit të Lartë (IAL) të huaja. UAMD rezultoi fitues në 3 projekte të diplomave të dyfishta në kuadër të ndërkombëtarizimit financiar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.

Deri tani, janë 13 programet e Bashkimit European që po zbatohen në UAMD. Ndërkohë, ka vijuar procesi për implementimin e projekteve që po zbatohen aktualisht në UAMD konkretisht për projektet: ENTRAL, QUADIC, KALCEA, STAND, IDEA, ENGINE, U-SIA, MEPM, TTO4FOOD, Value- X, CBHE Erasmus + ku UAMD është institucion partner dhe VTECH ku UAMD është lider.




(Në tabelën e mësipërme është shprehur në % numri i lektorëve për publikime shkencore dhe % e citimeve për lektor)




- 1 FAKULTETI I BIZNESIT
- 2 FAKULTETI I STUDIMEVE PROFESIONALE
- 3 FAKULTETI I EDUKIMIT
- 4 FAKULTETI I SHKENCAVE POLITIKE JURIDIKE
- 5 FAKULTETI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

Përqindja e publikimeve për lektor me kohë të plotë



Përqindja e citimeve për lektor me kohë të plotë



(Në tabelat e mësipërme është shprehur në % numri i lektorëve për publikime shkencore dhe % e citimeve për lektor)

Revista shkencore e UAMD “Interdisciplinary Journal of Research and Development” mund të aksesohen në faqen Web të Institucionit ose duke skanuar kodin në këtë faqe.



STUDENTËT

Njësitë bazë në UAMD janë përgjegjëse për procesin e pranimi të studentëve. Këto të fundit në mënyrë unanime, përcaktojnë kriteret e pranimi të studentëve të rinj për çdo vit akademik. Bazuar në nenin 74 të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e artë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, kriteret e pranimi për vitin akademik 2021-2022 për ciklin e parë dhe të dytë të studimeve, u miratuan sipas propozimeve të departamenteve në fakultetet përkatëse.

Kriteret e miratuara nga Senati akademik, publikohen në faqen zyrtare të UAMD, dhe i prezantohen komunitetit të maturantëve sipas një kalendari të informimit në institucionet e arsimit të mesëm e të lartë.



Karriera dhe Alumni

Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës realizon këshillim dhe udhëzime në lidhje me orientimin dhe zhvillimin e karrierës profesionale të studentëve në Universitetin “Aleksandër Moisiu”

Durrës; Organizon dhe koordinon aktivitetet për studentët të tilla si: trajnime, seminare, konferenca studentore, orë leksioni të hapura nga lektorë të ftuar, promovim të aftësive të studentëve si në letërsi, pikturë etj.

Organizimi i aktiviteteve studentore janë një pikë kyçe e Sektorit të Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës. Qendra asiston dhe mbështet çdo kërkesë për organizim aktiviteteve dhe stafi i tij është gjithmonë i pranishëm në aktivitetet e organizuara në UAMD.

Drejtorja e Administrimit dhe Shërbimeve Akademike në Universitetin “Aleksandër Moisiu” dhe RISI Albania kanë hartuar “Udhëzuesin e Karrierës”.

Ky udhëzues do t’ju vijë në ndihmë studentëve dhe Alumni UAMD për të përfituar maksimumin në çdo situatë që iu paraqitet në tregun e punës dhe për t’iu shërbyer si shtysë për një fillim të mbarë. Udhëzuesi përmban këshilla dhe motivimin që kërkohet për të vlerësuar situatën tuaj të tanishme dhe mundësitë profesionale, si dhe ofron një sërë sugjerimesh lidhur me procesin e aplikimit.

Informacioni dhe ushtrimet në të iu vlejné studentëve edhe për t’u përgatitur për këshillimin e personalizuar nga punonjësit e Zyrës së Karrierës në universitet.

Udhëzuesi është bazuar në përvoja të mira ndërkombëtare. Përgatitja e tij u mundësua falë mbështetjes nga RisiAlbania, një projekt i “Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim” dhe i zbatuar nga “Helvetas” dhe “Partnerët Shqipëri”.

Zyra e Karrierës UAMD synon krijimin e mundësive për praktika profesionale, trajnime për studentët aktualë dhe ata që janë diplomuar pranë Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, si dhe hapësira punësimi falë marrdhënieve të bashkëpunimit dhe kontakteve që ky institucion ka me ndërmarrje dhe organizata të ndryshme jo publike, të cilat veprojnë në tregun e punës.

Zyra e Karrierës gjatë vitit akademik 2021-2022 ka ndërmarrë disa veprimtari, si në bashkëpunim dhe me organizata të tjera me qëllim njohjen e studentëve me funksioneve/pozicionet që po krijohen për të rinjtë, si dhe aftësitë e kërkuara për pozicionet e punës fillestare; pajisja e studentëve me njohuritë bazë për të qene pjesë e tregut të punës; përgatitja sa me e plotë e dokumentacioneve të nevojshme për punësimin si dhe krijimin e planeve të karrierës.

Në aktivitetet tona kemi pasur grupe të marginalizuara.

- përvec datave te trajnimeve, janë edhe aktivitetet me të ftuar, rasti i Global Leadership Partners nga SHBA-të.
- Kategorizimi i bërë mes shërbimeve dhe outreach, është bërë herën e fundit të raportimit bashkë me Risi Albania.
- Të gjitha trajnimet kanë listëprezencë, vlerësimin në fund të tij, dhe studentëve iu jepet certifikatë (si stimul për të ndjekur trajnimin).

Një përmbledhje të shërbimeve dhe outreach të zyrës për këtë vit akademik e gjeni këtu:

Shërbime karriere:	Numri i pjesëmarrësve
9 trajnime për CV, Letër Motivimi, Intervistë	240
3 aktivitete për CV, Letër Motivimi nga profesorë nga SHBA	220
Këshillim individual "in person"	62
Total	522

Outreach	Numri i pjesëmarrësve
4 Alumni talks	80
Ligjëratë e hapur dhe diskutim mbi karrierën dhe punësimin e të rinjve në vend me Blendi Fevziun	250
Këshillim individual online nga stafi	1300+
Total	1630+

U organizua për te dytin vit rradhazi në Universitetin "Aleksandër Moisiu" në Durrës, "Panairi i Punës dhe Karrierës". Ky panair u zhvillua me datë 14 prill 2022, në të cilin morën pjesë rreth 200 biznese nga Durrësi, Tirana dhe më gjërë.

Në këtë event ishin pjesëmarrës qindra studentë, të cilët për disa orë me radhë vizituan standat e institucioneve shtetërore, sipërmarrjeve dhe organizatave të ndryshme. Zhvillimi i këtij panairi është një mundësi e vyer për të gjithë studentët pjesëmarrës, për t'u njohur më nga afër me mundësitë e ofruara për praktika profesionale dhe punësim.



(Figura nr.1 dhe Figura nr.2 të marra gjatë "Panairit të Punës dhe Karrierës")

Zyra e Karrierës pranë UAMD në bashkëpunim me RISI Albania, ofrojnë venien në dispozicion për studentet e “Udhezuesit të Karrierës” nga sektori i karrierës dhe alumnit në formë elektronike dhe e shtypur. Ky udhezues është pasuruar me përdorimin e pyetsoreve profesionale për studentet si :

1. Inventari I Globit Personal
2. Pyetsor I vështirësive në procesin e vendimarrjes për karrierën
3. Analizë e kërkesës për orientim

Informacioni dhe ushtrimet në to u vlejné studentëve edhe për t’u përgatitur për këshillimin e personalizuar nga punonjësit e Zyrës së Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës



(Gjatë panairit “Work and Study”)

Studentët në UAMD kanë akses ndaj literaturave të ndryshme, në gjuhën shqipe dhe atë të huaj. Përsa i përket vënies në dispozicion të literaturave të detyruara të lëndëve përkatëse, studentët e aksesojnë atë, të paktën në njërën prej 3 bibliotekave nën administrimin e UAMD. Shoqata Alumni ka si qëllim kryesor nxitjen e frymë së përkatësisë dhe bashkëpunimit midis Universitetit “Aleksandër Moisiu” dhe ish-studentëve, në mënyrë që të promovojë dhe avancojë interesat e përbashkëta të të dyja palëve. Alumni UAMD mbështet qëllimet e Universitetit dhe punon për të forcuar lidhjet midis ALUMNI-t si komunitet dhe UAMD-së.

Shoqata Alumni, ofron mbështetje për studentët në drejtim të njoftimeve për punësim, shkëmbi përvojash, trajnime, seminare, workshope etj. Tashmë në UAMD është bërë traditë transmetimi i përnuajtshëm i Rubrikës “Alumni talks” në rrjetet sociale të UAMD. Kjo e fundit konsiston në intervistimin e Alumni të suksesshëm të UAMD dhe synon që të sjellë përvojën dhe këshillat e Alumnive për të rrugëtim të suksesshëm në karrierë. Për studentët e ciklit të parë dhe të dytë në UAMD ofrohet shërbimi i mentorimit me qëllim lehtësimin e integritimit në jetën akademike, përballimin e kërkesave gjatë viteve të studimit dhe duke synuar zhvillimin e potencialeve të studentëve në fushën akademike dhe atë personale.

UAMD ofron për studentët në praktikat mësimore dhe në fazat e përgatitjes së temës së diplomës bachelor dhe mikrotezës së masterit, një lektor udhëheqës, i/e cila këshillon, mentoron, orienton studentin mbi materialet burimore në dispozicion për përpunimin e temës, dhe udhëheq procesin për të finalizuar një product sa më pranë kriterëve akademike duke nxitur rezultate të larta. Sektori i Karrierës dhe Alumnit (Karriera UAMD), mirëpriti për një javë z. Visar Ademi, Drejtor Ekzekutiv i organizatës "Moja Kariera" në Maqedoninë e Veriut I cili punoi ngushtësisht me stafin e Karriera UAMD.



Karriera UAMD punon për:

- përmirësimin e shërbimeve që Karriera UAMD ofron për studentët, si dhe raportuar më mirë për institucionin dhe donatorët;
- diversifikimin e shërbimeve të Karriera UAMD, përfshirë ofrimin e trajnimeve për aftësitë e buta;
- ngritjen e një kuadër rregullator për ofrimin dhe mbarëvajtjen profesionale të praktikave të punës.

Klubet studentore në UAMD kanë si qëllim forcimin e kapaciteteve dhe promovimin e përfshirjes dhe angazhimit të studentëve në jetën universitare. Për këtë UAMD organizon aktivitete që ndihmojnë studentët të menaxhojnë më mirë jetën studentore dhe ndërveprojnë me njëri-tjetrin për të arritur qëllime të përbashkëta.

1. Klubi për Shoqëri të Ndjeshme (me tri ndëndarjet e tij #EarthTeam, #SocialTeam dhe #CultureTeam),
2. Klubi i Librit,
3. Klubi i Multimedias dhe Fotografisë,
4. Klubi i Debatit,
5. Klubi i Juristëve të Rinj,
6. Klubi artist
7. Klubi Diplomatik
8. Klubi I Shahut
9. Klubi Volejbollit
10. Klubi Basketbollit
11. Klubi FUTBOLLIT
12. Klubi Teknologji dhe Informacion
13. StartUp UAMD



Shpalosin ide të shkëlqyera që jo vetëm gjallërojnë jetën studentore, siç kanë bërë deri tani, por edhe shtrihen më gjerë në shërbimet komunitare. Për aktivitete kulturore studentët organizojnë: Klubin e Librit dhe Klubin e Artit. UAMD përfshihet përmes grupimeve të studentëve në nisma që promovojnë vlerat e respektit, frymës ekipore, përgjegjësisë dhe këmbënguljes; ato nxisin talentin dhe inkurajojnë të rinjtë për të patur një stil jetese të shëndetshëm



(Figura 1 dhe Figura 2 nga Ceremonia Diplomimit 2021-2022)

Shërbimet ndaj studentëve – Sekretaria Mësimore

Sekretaria Mësimore e çdo fakulteti përpilon, administron dhe është përgjegjëse për mirëmbajtjen e regjistrit themeltar (bazë) të shkruar me dorë dhe me kompjuter, si dhe për regjistrat e kurseve⁹(Neni 44, i rregullores). Sekretaritet Mësimore të njësive kryesore mbajnë regjistër bazë (themeltar) të studentëve me të dhëna personale të tyre, vlerësimet e marra gjatë ndjekjes së programit të studimit, të dhëna mbi diplomën ose diplomat e marra bashkë me suplementin e diplomës etj, të formatuara këto sipas standarteve ligjore.

Sekretaritet mësimore në Fakultete të ndryshme janë në varësi të Dekanit përkatës dhe secila prej tyre drejtohet nga Kryesekretarja me përgjegjësi koordinimin dhe monitorimin e mbarëvajtjes së punës. Funksionimi i tyre është konform rregulloreve përkatëse të Fakulteteve.

Shërbimet e ofruara nga sekretaria mësimore për studentë:

- regjistrimi i kandidatëve fitues
- hapja dhe ruajtja e dosjeve personale për çdo student, (dokumentacioni i regjistrimit të studentit në institucion, lëndët dhe vlerësimin deri në përfundim të ciklit mësimor, rezultatet e provimeve)
- administrimi në formë shkresore i listave të rezultateve të provimeve të cilat vijnë nga lektorët në format elektronike bazuar në sistemin e menaxhimit

- përgatitja e transkriptit (listë notash) për studentin
- përgatitja e dokumentave që i dorëzohen institucioneve zyrtare si:

a) Vërtetim Studenti

b) Rekomandime

c) Dokumente të tjera të ngjashme

- plotësimi i diplomave të studentëve, të cilët kanë fituar të drejtën për t'u diplomuar
- dorëzimi i diplomës studentëve të diplomuar kundrejt firmës
- ndjekja e procedurave të studentëve të cilët duan të ndërpresin studimet universitare, kryen ç'rregjistrimet
- evidentimi i studentëve të cilët nuk kanë arritur të përfundojnë me sukses studimet brenda afatit maksimal të përcaktuar në aktet ligjore dhe ia përcjell Dekanit

Sekretaritet mësimore janë përgjegjëse për përgatitjen dhe furnizimin e studentëve me informacionin e nevojshëm rreth programit të studimit, programit lëndor (syllabus), orarin dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm të kërkuar nga studentë.

Shërbimet ndaj studentëve – Biblioteka

Biblioteka e Universitetit “Aleksandër Mosiu” funksionon një bibliotekë me fonde të hapura dhe hibride, ajo mundëson kërkim të informacionit “online”, në sallën e leximit, skedarë elektronikë, lehtësira në kërkimin bibliografik të informacionit, mundësi shfletimi të literaturës elektronike pranë kompjuterave të sallës. Biblioteka ka në përbërjen e saj sallë kompjuterash, e cila i mundëson përdoruesve përdorimin e kompjuterave, zhvillimin e aktiviteteve, trajnim mbi përdorimin e katalogut online, etj.

Me shfrytëzimin e sistemeve me bazë “kod të hapur”, mbështetur në udhëzimet e Bashkimit Europian, nenit nr. 179 të Traktatit të Lisbonës mbi burimet e hapura (open access), me mbështetjen e IFLA-s, Biblioteka Universitare, në shtator 2014, instaloi falas Katalogun Online të Integruar, për menaxhimin e fondit të saj. Katalogu ofron një version të avancuar në kërkimin e informacionit. Përveç përshkrimit bibliografik, katalogu ofron falas në formatin elektronik artikuj, teza, kërkimin shkencor dhe disertacionet e stafit akademik të Universitetit “Aleksandër Moisiu”.

Biblioteka përfaqësohet gjithashtu në Bibliotekën Virtuale të Shqipërisë “COBIB.AL”. Që nga tetor 2009, në Bibliotekën Universitare mbërrijnë periodikisht publikime nga Zyra e Publikimeve të BE-së në Luksemburg, falë bashkëpunimit të projektit “EU info point”



Orari i shërbimit të përdoruesve: e hënë-e shtunë 08.00-16.00.
Shërbimi i informacionit elektronik (e-mail/katalog elektronik)

E hënë-e diel 08.00-20.00

Biblioteka ofron ndihmë për qasjen e dy prej bibliotekave virtuale më të mëdha botërore si EBSCO dhe JSTOR, të cilat ofrohen për stafin akademik, administrativ dhe studentët.

Duke synuar gjithëpërfshirjen e studentëve në aktivitetet jashtë detyrimeve akademike, biblioteka organizon takime letrare, artistike dhe kulturore në ambientet e saj, duke synuar kështu, gjallërimin e jetës studentore.



Lidershipi Studentor

Lidershipi studentor UAMD ka si qëllim angazhimin dhe përfshirjen e studentëve në jetën universitare si dhe zhvillimin e kapaciteteve të këtyre të fundit. Përfshirja e studentëve në klubet studentore, i krijon hapësira për të kuptuar që UAMD nuk jep vetëm dije, por dhe edukon. Klubet e leximit, ato sportive dhe të shkencave kompjuterike dhe shoqërore presin krahëhapur studentë të rinj.

Klubi i Debatit
Klubi i
Multimedias dhe
Fotografisë
StartUp UAMD
Klubi për Shoqëri
të Ndjeshme

Klubi i Juristëve të
rinj
Klubi Diplomatik
Klubi i Shahut
Klubi i Artit
Klubi i Librit

Ekipe sportive
Ekipi i Futbollit
Ekipi i Basketbollit
Ekipi i Volejbollit
Meshkuj/Femra
Ekipi i Futsalit



U organizua në Durrës " Kupa Universitare Mbarëkombëtare " mes kampioneve të Universitetit të Prishtinës dhe Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës . Aktivitetin e nderuan me pjesëmarrjen e tyre Presidenti i Komitetit Olimpik Shqiptar z . Fidel Ylli dhe dy presidentët e Federatave respektive , z . Besnik Veliu dhe znj . Diellza Shaqiri Kelmendi . Universiteti " Aleksandër Moisiu " është krenar që priti këtë aktivitet në Durrës dhe që me studenten Liridona Rexhaj u shpall Kampion Mbarëkombëtar në Pingpong

PIKA TË FORTA TË INSTITUCIONIT

Mundësitë

Të ketë përfitime nga grantet kërkimore ku mund të përfshihen dhe angazhohen edhe studentët.

Të mundësohet transformimi i universitetit në një aktor të zhvillimit rajonal dhe kombëtar.

Të mundësohen dhe realizohen marrëdhënie bashkëpunimi me bizneset dhe grupet e tjera të interesit.

Të mundësohet hapja ose riorganizimi i programeve më fleksibël të studimit.

Organizimi institucional

Organizimi dhe funksionimi i institucionit është realizuar dhe zbatohet në përputhje me parashikimin e statutit dhe rregulloreve të tij të brendshme. Institucioni duke pasur një strukturë të brendshme autonome, ka bërë dhe bën përpjekje të vazhdueshme për ndërkombëtarizimin e aktivitetit të tij mësimor dhe shkencor, përmes marrëveshjeve të suksesshme me institucione të tjera, kombëtare dhe ndërkombëtare.

Vendimmarrja institucionale bazohet në organe kolegjiale, të ngritura sipas legjislacionit, duke garantuar në këtë mënyrë pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve të institucionit si edhe objektivitet e transparencë në vendimmarrje.

Realizimi me sukses i akreditimit institucional të universitetit dhe puna e vazhdueshme për akreditimin e të gjitha programeve të studimit.

Burimet

Funksionet dhe detyrat e organeve akademike dhe administrative, si dhe përshkrimet e punës për çdo pozicion janë përcaktuar qartë nëpërmjet rregulloreve përkatëse të institucionit, duke siguruar kështu menaxhimin efikas të aktivitetit të tij.

Sistemi i informimit të institucionit është i mirëorganizuar dhe efektiv, i cili u mundëson studentëve dhe personelit sigurimin e një informacioni të plotë rreth procesit akademik dhe administrativ.

Institucioni gëzon pasuri të paluajtshme dhe mjedise kampusi universitar, duke siguruar një infrastrukturë të përshtatshme për organizimin e veprimtarisë akademiko-shkencore, si edhe angazhohet në mënyrë të vazhdueshme për ndjekjen dhe përmirësimin e tyre.

Stafi akademik efektiv duke pasur një nivel kualifikimi në rritje, përbënnjë pikë mjaft të fortë, i cili garanton implementimin me sukses të programeve në të gjitha ciklet e studimit.

➤ Kurrikula cilësore dhe fleksibël

- Mundësimdhënie sigurimi për një përgatitje e formim cilësor teorik në përputhje me kërkesat e tregut.
- Organizimi i programeve të studimit me objektiva të përcaktuara qartë, bën të mundur që ato të jenë lehtësisht të kuptueshme dhe të arritshme.
- Ngarkesa mësimore e stafit akademik bëhet në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet nënligjore në fuqi.
- Vlerësimi dhe zhvillim politikave mbështetëse nga institucioni për ecurinë dhe mbarëvajtjen e studentëve.
- Organizimi i programeve akademike u mundëson studentëve të praktikojnë aftësitë teorike dhe të përgatiten për të qenë të aftë në tregun e punës.
- Mundësimi i vlerësimit cilësor të dijeve teorike dhe praktike të studentëve, nëpërmjet provimeve të ndërmjetme dhe përfundimtare përgjatë fazave të kontrollit të dijeve, sipas një sistemi unik i ndërtuar dhe bazuar në eksperiencën e universiteteve amerikane.
- Cilësia e programeve të studimit dhe aplikimi që në hapje e Kartës së Bolonjës për mobilitetin e pedagogëve dhe studentëve, ka mundësuar ndër vite që shumica e ish studentëve të UAMD, të ushtrojnë profesionin dhe të japin kontributin e tyre në institucion, duke qenë pjesë e stafit akademik të Fakulteteve të Universitetit, si edhe në universitetet e tjera brenda vendit, ose të punojnë në institucione e kompani të ndryshme.
- Përdorimi i metodave interaktive dhe efektive, orientimi drejt risive dhe inovacionit në mësimdhënie e kërkimin shkencor, ka mundësuar krijimin e një qasje ndaj studentëve, duke i ndihmuar në mësimnxënie, në kuptimin konceptual të situatave komplekse me karakter ekonomik dhe jo vetëm, krijimin e aftësive krijuese për të gjeneruar ide të reja mbi teorinë, produktet, njohuritë etj.
- Studimi i tregut nga departamentet e fakulteteve të Universitetit, mundëson hapjen e programeve të reja të studimit nëpërshtatje me të mirë ndaj kërkesave të tregut, si dhe do të ndikojë pozitivisht në preferencat e studentëve të të dy cikleve të para të studimit.

➤ Infrastrukturë moderne

- Godinat e reja të ndërtuara në kampusin universitar sigurojnë një rishpërndarje më efikase të hapësirave fizike, të cilat ndikojnë pozitivisht në një shfrytëzim më efikas të orarit mësimor ditor, duke mundësuar kështu hapësira të lirakohore dhe facilitete për studentët

Partneritetet

- Stafi akademik i universitetit ka patur dhe vazhdon të ketë në mënyrë të vazhdueshme mundësi të shumta trajnimi dhe shkëmbimi eksperiencash me IAL partnere brënda dhe jashtë vëndit.
- Studentët kanë mundësinë të zhvillojnë eksperiencë të reja, të larmishme, në saj të programeve të ndryshëm si Erasmus +, duke iu ofruar mundësi të frekuentojnë studimet për një semestër në disa IAL më të mira të Bashkimit Europian.
- Universiteti ka siguruar nërkombëtarizimin e tij, duke qenë pjesë në shumë projekte të larmishme evropiane.

Praktikat mësimore

- Mundësimi dhe siguri i marrëveshjeve të shumta të politikave të bashkëpunimit të universitetit me institucione të tjera, i jep studentëvetë UAMD-së, mundësinë e përzgjedhjes së institucioneve më të mira për të realizuar praktikat mësimore.

Staf i kualifikuar

- Trendi pozitiv në kualifikimet e stafit të UAMD-së ndër vite, nëdrejtim të marrjes së gradave shkencore dhe titujve akademikë, por jo vetëm.
- Komunikimi efektiv dhe produktiv studentë-pedagog.
- Rritja e vazhdueshme e mobilitetit të stafit akademik.
- Pjesëmarrja gjërë dhe aftësimi i stafit akademik në procesin e kërkimit shkencor, si edhe angazhimi i vazhdueshëm i pedagogëve në botime e studime shkencore, në organizimin periodik të konferencave shkencore, botimin e monografive, artikujve shkencorë, teksteve mësimore apo studimeve të realizuara prej tyre, etj.

Punësimi

- Puna dhe bashkëpunimi i zyrës së ALUMNI-t dhe stafit akademik, të cilët ruajnë në mënyrë të vazhdueshme kontakte me komunitetin e biznesit dhe studentët, mundësojnë sot disponimin e statistikave të besueshme mbi rezultatet pozitive të punësimit të të diplomuarve në UAMD.
- Rritja profesionale e stafit të sektorit të Karrierës dhe ALUMNI-t nga pjesëmarrja në projekte të rëndësishme për zhvillimin e karrierës ku UAMD bën pjesësiq janë: trajnimet e stafit nga Risi Albania dhe GRADUA (Erasmus +) një projekt që synon të krijojë në Shqipëri një platformë inovative të bazuar në IT për ndjekjen e të diplomuarve, sidhe punësimin e tyre, në mbështetje të hartimit të politikave dhe reformës së arsimit të lartë.

Aktivite në shërbim të studentëve

- Stafi akademik i çdo fakulteti në UAMD ofron një program të larmishëm aktivitetesh me karakter social dhe edukativ, me fokus studentët, me qëllim ngjalljen e interesit në funksion të procesit mësimor, si edhe thellimin e njohurive përmes të ftuarve dhe personaliteteve të shquara nga fusha të ndryshme të biznesit, shkencës, artit etj.

Rekomandime për rritjen e cilësisë në UAMD

- Të përfshihet praktika profesionale në të gjitha programet e ciklit të parë të studimit bachelor, për të plotësuar ato kurrikula ku praktika nuk është e detyrueshme.
- Të mundësohet dhe të ketë një shtim e zgjerim të shërbimeve infrastrukturore komplementare në funksion të studentëve si: mensë, konvikte apo shërbime të tjera ndihmëse.
- Të krijohet një mekanizëm mentorimi si në IAL të ndryshme të sistemit Anglosakson (Faculty to faculty mentoring), me anë të të cilit, stafi akademik i kategorise “Profesor” dhe “Lektor” të garantojë cilësinë e stafit akademik të kategorisë asistent lektor.
- Të përmirësohet cilësia e mësimdhënies nga pedagogët të vlerësuarjopozitivisht nga studentët, përmes instrumentave dhe treguesve të matshëm.
- Të ketë një rifreskim të vazhdueshëm të literaturës bazë dhe asaj ndihmëse për çdo lëndë, me literaturën bashkëkohore.
- Të mundësohet organizimi dhe zhvillimi i studimeve të vazhdueshme të tregut me të dhëna sasiore dhe cilësore nga UAMD, në bashkëpunim të ngushtë me partnerët e saj, me qëllim që të realizohen ndryshimet e nevojshme në kurrikulat e programeve të studimit.
- Të zgjerohet përfshirja e lëndëve në gjuhën angleze edhe në ciklin e dytë të studimit master, me qëllim që studentët të adaptohen më lehtë me tregun e huaj të punës.